REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E SHËNDETËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH
Njësia Org. / Org.Jedinica / Org Unit 02
Nr.Prot: / Broj Prot: / Prot.No: 05-5021
Nr.i faqeve / Br.stranica / No.pages -4-
Data: / Datum: / Date: 15/07/2026
Prishtinë / a

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Shëndetësisë/Ministry of Health/Ministarstvo Zdravstva

PROCEDURA STANDARDE OPERATIVE/PSO

EMRI I PSO: MARRJA, TRANSPORTI DHE PËRPUNIMI I MOSTRËS SË GJAKUT/HEMOKULTURA ME METODËN BIOFIRE-BLOOD PANEL

PËRMBAJTJA: DOKUMENTI PËRFSHINË HAPAT KRYESORË TË MARRJES SË MOSTRAVE, TRANSPORTIT DHE PËRPUNIMI I MOSTRËS SË GJAKUT /HEMOKULTURA ME METODËN BIOFIRE-BLOOD PANEL, DUKE SIGURUAR QË TESTIMI TË KRYHET NË MËNYRË TË SAKTË DHE TË STANDARDIZUAR PËR IDENTIFIKIMIN E BAKTERIEVE PATOGJENE

VERSIONI:1.0
DATA E APROVIMIT:15.07.2026.
AUTOR: MSH/IKSHPK
NR. I HAPAVE: VI
NR. I NËNHAPAVE: 36

APROVUAR: Jahë Gecaj
U.D. Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Shëndetësisë

_____ V.V

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - MINISTRIA E SHËNDETËSISË - MINISTARSTVO ZDRAVLJA - REPUBLIC OF KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA - MINISTRY OF HEALTH
Prishtinë / a

QËLLIMI	QËLLIMI I KËSAJ PSO ËSHTË TË SIGUROJË NJË QASJE TË STANDARDIZUAR PËR MARRJEN E MOSTRËS, TRANSPORTIN DHE KULTIVIMIN E MOSTRËS SË GJAKUT/HEMOKULTURA ME METODËN BIOFIRE-BLOOD PANEL;
NDËRLIDHJA ME AKTET	DORACAKU PËR MENAXHIMIN E CILËSISË NË LABORATORË, 2025; LIGJI NR. 08/L-200 PËR PARANDALIMIN DHE KONTROLLIN E SËMUNDJEVE NGJITËSE; PLANI STRATEGJIK KOMBËTAR PËR LABORATORE 2024-2030; PSO PËR ASGJËSIMIN E MBETURINAVE MEDICINALE –MSH, GUSHT 2023; PSO DEKONTAMINIMI NË RASTE TË DERDHJES SË MATERIALIT TË RREZIKSHËM DHE RREZIQEVE TJERA TË LABORATORIT; PSO- ZBATIMI I MASAVE TË BIOSIGURISË PËR MBROJTJE PERSONALE (BIO-P01-V1.0) PSO- PËRDORIMI DHE MIRËMBAJTJA E INKUBATORIT NË LABORATOR (BIO-P02-V1-0)
LISTA E SHKURTESAVE	PSO - PROCEDURA STANDARDE OPERATIVE PPM - PAJISJET PERSONALE MBROJTËSE

Nr.	HAPI	NËN-HAPAT
[I]	Zbatimi i masave për menaxhim të mostrave	1. Mostra merret nga infermieri në klinikë ose nga laboranti në zyrën e pranimit; 2. Mostra transportohet nga laboranti në zyrën e pranimit deri në laboratorin përkatës, me kohë dhe në mënyrë të sigurt; 3. Laboranti kryen pranimin, përfshirë inspektimin e mostrës, ndarjen, përpunimin dhe ruajtjen e saj sipas kritereve të pranimit dhe refuzimit të mostrave për testim mikrobiologjik në Doracakun e Cilësisë.
[II]	Reagjentët dhe pajisjet që janë të nevojshme për testim:	1. Sigurohu që të gjitha pajisjet dhe reagjentët e mëposhtëm janë të disponueshëm dhe funksionalë para fillimit të testimit; 1.1. Pajisjet përfshijnë: a. Shishe hemokulture aerobike dhe anaerobike; b. Kabinet të biosigurisë klasa II; c. Pipeta dhe maja sterile; d. Instrumenti BioFire FilmArray System; e. Kit-i BioFire FilmArray BCID2 Panel (Pouch); f. PPM.
[III]	Veprimet laboratorike të marrjes dhe transportit të mostrës	1. Verifiko identitetin/të dhenat e pacientit ; 2. Mostra duhet të merret para fillimit të terapisë antibiotike kur është e mundur; 3. Dezinfekto lëkurën me alkool 70%; 4. Lëre të thahet për minimum 30 sekonda; 5. Nga të rriturit merren 20–30 mL gjak për një set hemokulture (10 mL në secilën shishe); 6. Në Pediatri, sasia merret sipas peshës trupore dhe protokollit pediatrik; 7. Të merren dy sete nga vende të ndryshme venoze; 8. Etiketa duhet të përmbajë: a)emrin dhe mbiemrin (viti i lindjes, nr. personal, adresa), b)numrin identifikues/protokolli, c)datën dhe orën e marrjes, d)klinika/reparti, e)inicialet e personit që ka marrë mostrën; 9. Mostra transportohet menjëherë në laborator; 10. Temperatura e transportit: 20–25°C; 11. Mostrat nuk duhet të ruhen në frigorifer; 12. Koha optimale e transportit: brenda 2 orëve;
[IV]	Veprimet laboratorike të testimit të mostrës	1. Kontrollo integritetin dhe etiketimin/të dhënat e mostrës; 2. Regjistro mostrën në sistemin laboratorik; 3. Të përdoret PP; 4. Vendos shishet në sistemin/aparaturën automatike të hemokulturës;

		5. Inkubimi kryhet sipas udhëzimeve të prodhuesit (zakonisht deri në 5 ditë); 6. Mostrat Negative nuk përpunohen dhe interpretohet rezultati; 7. Mostrat Pozitive përpunohen në kabinet të biosigurisë klasa II; 8. Të përdoret PPE; 9. Përziej lehtësisht shishen pozitive; 10. Transferohet në pouch të BioFire Joint Infection Panel sipas udhëzimeve të prodhuesit; 11. Pouch vendoset në FilmArray instrument sipas udhëzimeve të prodhuesit; 12. Instrumenti kryen automatikisht ekstraksionin e ADN/ARN, amplifikimin me PCR multipleks dhe detektimin e patogjenëve (bakterialë, viralë, fungalë); 13. Rezultatet gjenerohen dhe shfaqen në ekranin e aparaturës FilmArray; 14. Ndiq kontrollin e brendshëm të sistemit.
[V]	Veprimet laboratorike të raportimit të rezultatit	1. Laboranti vendos të dhënat e regjistruara në fletëpërcjellëse nga ana e mikrobiologut në sistemin informativ të laboratorit; 2. Laboranti vendos të dhënat në librin e protokollit të laboratorit, respektivisht në databazat përkatëse të laboratorit; 3. Mikrobiologu bën raportimin e rezultateve duke përfshirë verifikimin e saktësisë së analizave të raportuara nga laboranti, të dhënat për patogjenët e identifikuar dhe çdo koment ose rekomandim shtesë për trajtim (p.sh., ndjeshmëria ndaj antibiotikëve specifikë) sipas interpretimit nga ana e tij.
[VI]	Veprimet e tjera laboratorike të raportimit të rezultatit	1. Ndiq kontrollin e brendshëm të sistemit; 2. Kryej mirëmbajtje sipas rekomandimeve të prodhuesit; 3. Dokumento të gjitha devijimet

Referencat:

- Manuali i përdorimit i bioMérieux për BioFire FilmArray Blood Infection Panel.
- Biosafety in Microbiological and Biomedical Laboratories (BMBL) 6th Edition, CDC;
- WHO Laboratory biosafety manual, 4th edition;
- ISO 15189:2022;
- Procedurat e sistemit të menaxhimit të cilësisë së laboratorit.
- World Health Organization (WHO) guidelines for laboratory biosafety.